



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.472/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.02.2025, mori këtë:

VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa A.nr.472/2025 e datës 09.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se Më 8 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Podujevë ka identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të kandidatëve për deputet të AAK-së, Besnik Tahiri, në sheshin e qytetit, në Podujevë. Ky baner/poster është vendosur pa leje të organeve kompetente, në hapësirën e jashtme të ndërtesës kolektive- publike. Me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik AAK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Fotografji që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Më datë 09.02.2025, PZAP, e njoftoi subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 10.02.2025 në ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 10.02.2025 theksohet se ajo që është thelbësore është fakti se nga prova e bashkëngjitur nuk mund të përcaktohet se kush është në atë poster. Për më tepër, ajo duket më shumë si një ekran televiziv që përdoret për qëllime reklamimi dhe më e rëndësishmja është se nuk dallohet as subjekti politik që shfaqet atje, dhe as figura e z. Tahiri. Për këtë arsye, në kushte të pasigurisë dhe konfuzionit në lidhje me identitetin e personit në poster/ekran, nuk mund të ngarkohet përgjegjësia ndaj një individi apo subjekti të caktuar politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se Subjekti Politik Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës, ka vendosur posterë në hapësirat publike të kandidatit Besnik Tahiri përkatesisht në sheshin e qytetit të Podujevës, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkuara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim, paragrafi 2.2 vendosa e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat e trafikut publik, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna, ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizata ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve", pasi që në fotografinë e bashkangjitur në ankesë nuk mund të identifikohet qartë posterit i vendosur.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe pretendimet e palës ankuese paneli vlerësoi se pretendimi ankimor për vendosjen e posterit nga subjekti politik AAK në qytetin përkatësisht sheshin e Podujevës, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla Paneli i refuzoi për faktin se subjekti politik LVV nga veprimet e përshkuara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime janë ndërmarr nga subjekti politik kundër të cilit është paraqitur ankesa, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të Nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor/njoftime për tubimin politik, në hapësirat private/veturat e ndryshme.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.472/2021 më datën 11.02.2024



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.